Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-713
Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e III-t dhe të IV-t e mbajtur me datë 30.07.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** " Qendra për Aftësim Profesional "Diakonie Training Center" Mitrovice me adresë Rruga: Adrea Alleshi pn, 40000, Mitrovicë, Kosovë, për periudhën pese (5) vjeçare, përkatësisht nga data 04.03.2025 deri 03.03.2030, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1. **Instalues i ngrohjes qendrore Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK),** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 12 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Aftësimit Profesional për një vit kalendarik në total 6 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 24 kandidate/nxënës, ne pjesën praktike të ndare me nga 12 kandidate/nxënës që në total bëjnë 144 kandidate/nxënës (6x24=144) kandidate/nxënës për një vit.

   1.2. **Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit,** Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 12 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Aftësimit Profesional për një vit kalendarik në total 6 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 24 kandidate/nxënës, ne pjesën praktike të ndare me nga 12 kandidate/nxënës, që në total bëjnë 144 kandidate/nxënës (6x24=144) kandidate/nxënës për një vit.

   1.3. **Instalues elektrik,** Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 15 kredi të AAP. Institucioni mund të

realizojë procesin e Aftësimit Profesional për një vit kalendarik në total 3 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 24 kandidate/nxënës, ne pjesën praktike të ndare me nga 12 kandidate/nxënës që në total bëjnë 72 kandidate/nxënës (3x24=72) kandidate/nxënës për një vit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së " Qendra për Aftësim Profesional "Diakonie Training Center" për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 14,15,18.05.2026 për kualifikimin: Instalues i ngrohjes qendrore, Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe Instalues elektrik Niveli III sipas KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 19.05.2026 Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 15.06.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e III-t dhe të IV-t e mbajtur e Këshillit Drejtues të datës 30.07.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Për një vit kalendarik, për kualifikimin Instalues i ngrohjes qendrore, lejohen 6 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 24 kandidate/nxënës, ne pjesën praktike të ndare me nga 12 kandidate/nxënës që në total bëjnë 144 kandidate/nxënës (6x24=144) kandidate/nxënës për një vit. Ndërsa për një vit kalendarik, për kualifikimin Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit lejohen 6 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 24 kandidate/nxënës, ne pjesën praktike të ndare me nga 12 kandidate/nxënës që në total bëjnë 144 kandidate/nxënës (6x24=144) kandidate/nxënës për një vit. Ndërsa për kualifikimin Instalues elektrik lejohen (3) tre grupe brenda viti me nga 24 kandidate/nxënës, që në total bëjnë 72 kandidate/nxënës (3x24=72) Kjo shifër reflekton kapacitetin aktual të institucionit për të pranuar dhe përkrahur kandidatet/nxënësit në kuadër të këtij kualifikimi.

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për ri akreditim ka marr parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për ri akreditimin e kualifikimit si dhe kohën e shqyrtimit të dosjes së aplikimit, nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. " Qendra për Aftësim Profesional "Diakonie Training Center"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK